



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*  
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*  
*Ministry of Regional Development*

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Zhvillimit Rajonal shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zyrtar për Zhvillim Socio-Ekonomik
<b>Klasa e pozitës</b>	Profesional 2
<b>Koeficienti/Paga</b>	7
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	23/06/2022
<b>Afati për aplikim</b>	08/07/2022 - 15/07/2022
<b>Institucioni</b>	Ministria e Zhvillimit Rajonal
<b>Departamenti</b>	Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio - Ekonomike Rajonale
<b>Divizioni</b>	Divizioni për Performancë Socio-Ekonomike Rajonale
<b>Vendi i punës</b>	Prishtine
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00009245
<b>Kodi</b>	RPC0002988



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Të inkurajojë komunikim përgjatë rajoneve në mënyrë që të njihen fushat e zhvillimit (p.sh. tregtia, ambienti, ndryshimet klimatike, siguria, bujqësia, dimensionet shoqërore të globalizimit, punësimi, migrimi, hulumtimi dhe risitë, informimi i shoqërisë, transporti dhe energjia);
2. Të krijojë data bazën, të dhënat e statistikore të projekteve të financuara nga niveli qendror në komuna, si dhe të identifikoj projektet e komunave që kanë nevojë për financim apo bashke-financim nga burime të ndryshme;
3. Të identifikojë dhe të sjellë në pah problemet të cilat mund të paraqiten gjatë punës dhe të propozojë zgjidhje për punët specifike;
4. Të bashkëpunojë me agjencitë ndërkombëtare dhe agjencitë jo qeveritare që kanë të bëjnë me komunat ;
5. Të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet komunave dhe të rajoneve në mënyrë që të fuqizojë kohezionin ekonomik dhe social, të qëndrueshëm;
6. Të lexojë dhe të interpretojë dokumente siç janë ligjet, rregulloret dhe kërkesat e raportimit që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal të balancuar;
7. Të asistojë në përgatitjen e planit për ndërtimin e kapaciteteve të mëtejshme nga komunat për zhvillim socio ekonomik ;
8. Të kryejë detyra tjera me kërkesë të Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në Ekonomik, Drejtësi, Filozofi me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë punë në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



## 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

## 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 22/07/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net> )

## 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- 07.08.2022 në MZHR Objekti i Ish Rilindjes kati 10 -Salla e takimeve në ora 10:00 10:00

## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

- Njohuri të mira të punës me kompjuter, me aplikim të programeve Microsoft Word, Excell, Pover Poin dhe Acces.
- Të ketë njohuri të ligjeve, kodeve, rregulloreve të shtetit, si dhe të kërkesave të raportimit që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal;
- Shkathtësi të dëshmuara për vizion strategjik, shkathtësi dhe aftësi për planifikimin dhe për zbatimin e planeve;
- Shkathtësi të mira ndër-personale dhe mbajtje të kontakteve të rregullta me personat vendimmarrës;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e ekipit (punë ekipore);
- Shkathtësi të shkëlqyeshme komunikuese;

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

